



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 111/5 prot.

Tiranë, më 13.3.2024

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 736, datë 31.1.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Gentjan Habazaj
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 27.2.2024, është njoftuar vendimi nr. 736, datë 31.1.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Gentjan Habazaj, me funksion prokuror, aktualisht me detyrë Këshilltar ligjor në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik ushtron ankim ndaj vendimit nr. 736, datë 31.1.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Gentjan Habazaj, me funksion prokuror, aktualisht ushtron detyrën e Këshilltarit ligjor në Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe, në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1¹ e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Gentjan Habazaj, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (*në vijim referuar si Komisioni*), në zbatim të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Raportin për vlerësimin e pasurisë nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (*në vijim referuar si ILDKPKI*), Raportin e vlerësimit të figurës nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (*në vijim referuar si AKSIK*) dhe Raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (*në vijim referuar si KLP*), nga të cilat rezulton se:

2.1 ILDKPKI, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Gentjan Habazaj*”² ka referuar se:

- i Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- ii Ka mungesë dokumentacioni ligjor për burimin e krijimit të pasurive;
- iii Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv Nuk ka kryer deklaram të rremë;
- v Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 AKSIK, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar pranë Komisionit raportin nr. *** prot., datë **.10.2017, për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, dhe ka konstatuar: “*Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Gentjan Habazaj*”. Pas kërkesës së Komisionit, AKSIK ka përcjellë Raportin e përditësuar të kontrollit të figurës³ për subjektin e rivlerësimit Gentjan Habazaj, me të njëjtin konkluzion si në raportin fillestar, duke rikonfirmuar përshtatshmërinë e subjektit për vazhdimin e detyrës.

2.3 KLP, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt rivlerësimi, ka përcjellë pranë Komisionit Raportin⁴ për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit, z. Gentjan Habazaj.

3. Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, ka vlerësuar si vijon:

3.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** Komisioni, në përfundim në lidhje me kriterin e pasurisë, [...] bazuar në prova dhe bindjen e brendshme, çmoi se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të mjaftueshëm për pasuritë e krijuara, si dhe justifikon me burime të ligjshme krijimin e tyre, duke zbritur edhe shpenzimet e jetesës, sipas përcaktimeve të shkronjës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016 [...]⁵.

¹ Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, Dh dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

² Shkresa e ILDKPKI-së me nr. ***/** prot., datë **.7.2019.

³ Raporti i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë **.10.2023, të KDZH-së.

⁴ Raport i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. *** prot., datë **.10.2023.

⁵ Për më tepër referohuni në f. 38, të vendimit të Komisionit.

3.2 **Për kontrollin e figurës.** Komisioni ka arritur në përfundimin se: [...] *Në përfundim... subjekti i rivlerësimit, z. Gentjan Habazaj, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 [...]*⁶.

3.3 **Për vlerësimin e aftësive profesionale.** Komisioni, lidhur me këtë kriter, ka arritur në përfundimin se: [...] *në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv dhe konsiderohet “i aftë”, duke arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në kuptim të shkronjës “c”, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016 [...]*⁷.

4. **Vendimi i Komisionit.** Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, trupi gjykues i Komisionit, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a”, dhe nenin 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Gentjan Habazaj, prokuror, aktualisht me detyrë Këshilltar ligjor në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

II. Vlerësimi i Komisionerit Publik

5. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting). Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

6. Në krahasim me kompetencat e njohura Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

7. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

8. *Komisioneri Publik*, nga shqyrtimi i vendimit nr. 736, datë 31.1.2024, çmon se ai është i cenueshëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit. Nisur nga hetimi dhe vlerësimi që ka kryer Komisioni për të tria kriteret e rivlerësimit, ankimi i Komisionerit Publik, në rastin konkret, evidenton dhe parashtron si çështje për gjykim, rrethana dhe fakte ligjore, për të cilat vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën dhe të japë shpjegime bindëse, lidhur me rezultatet e hetimit administrativ mbi kontrollin e kriterit të pasurisë dhe vlerësimit të aftësive profesionale.

⁶ Për më tepër referohuni në f. 40, të vendimit të Komisionit.

⁷ Për më tepër referohuni në f. 48, të vendimit të Komisionit.

9. Për sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ky ankimi i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 736, datë 31.1.2024, të Komisionit, ushtrohet për kriteret e lartpërmendura të rivlerësimit.

III. Analiza e shkaqeve të ankimit

III. A *Kontrolli i pasurisë*

10. Lidhur me kontrollin e kriterit të pasurisë, referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-33, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik mban në konsideratë se, gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit (“Vetting” dhe ato periodike), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

11. Po ashtu, Komisioneri Publik i referohet në këtë aspekt dhe interpretimit gjyqësor, që gjen pasqyrim në jurisprudencën e Kolegjit, si gjykata e procesit, që shqyrton çështjet e juridiksionit të rivlerësimit dhe vendos standardet përkatëse, bazuar në parimet e përgjithshme të një procesi të rregullt ligjor.

12. Rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Gentjan Habazaj, ushtron detyrën e prokurorit prej vitit 2009, duke deklaruar interesat privatë për herë të parë në vitin 2009, e më pas, në mënyrë periodike për çdo vit, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

13. Nga aktet në dosje, në rastin konkret, rezulton e administruar shkresa nr. ***/* prot., datë **.4.2017, e DPPPP-së, me lëndë: “*Dërgim informacioni*”, drejtuar Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, ku, ndër të tjera, informon se, në funksion të procesit të rivlerësimit të z. Habazaj, është kërkuar informacion për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, nga ku kanë lindur dyshime për burimin e të ardhurave të investuara e të qarkulluara, nëpërmjet një numri të konsiderueshëm transaksionesh të evidentuara.

14. Nga ana e DPPPP-së, ky informacion rezulton të jetë dërguar për veprime të mëtejshme edhe pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me shkresën nr. ***/*, datë **.1.2017. I njëjti informacion rezultoi i përcjellë nga DPPPP-ja dhe në Komision, në kuadër të hetimit administrativ të kryer nga ky i fundit, për subjektin e rivlerësimit.

15. Nga shqyrtimi dhe krahasimi i deklaratave vjetore periodike dhe atë Vetting, dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, në datën **.1.2017, referuar nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, pasuritë për të cilat paraqesim shkaqe ankimi, janë:

16. Depozitë bankare në *** Bank, në vlerën 4.800.000 lekë, dhe cash në vlerën 700.000 lekë

16.1 Në D-Vett., subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: (a) “Depozitë në *** Bank, hapur më dt. **.2.2016. E kam pasur si depozitë në *** para funksionit si prokuror, në vlerën 5.400.082 lekë, depozituar nga prindërit në datën **.06.2003, nga kursimet e tyre. Vlera 4.800.000 lekë. Zotëroj 100%”; (b) Gjendje cash në shtëpi që më ka mbetur aktualisht nga kursimet nga paga si prokuror, diferenca e çmimit të shitjes së makinës Golf IV, me targa *** dhe diferenca e depozitës, çelur pranë *** Bank. Vlera 700.000 lekë”.

16.2 Në deklarin e tij të parë si subjekt rivlerësi, dorëzuar në ILDKPKI, në datën **.11.2009, subjekti deklaroi: “Depozitë bankare në emër të G. Habazaj, datë **.6.2003, *** Vlorë. Vlera 5.400.082 lekë”.

16.3 Në DV- 2009n subjekti ka deklaruar: “Depozitë bankare në emër të G. Habazaj, datë **.6.2009, *** Vlorë, është shtuar me derdhjen e datës **.12.2009, me vlerë 25.000 lekë kursime nga rroga. Vlera 5.425.082 lekë”.

16.4 Në DV- 2010, subjekti ka deklaruar: “Shumë paraje në të holla nga tërheqja e depozitës bankare dhe interesave të saj dhe kursimeve të rrogës në këtë depozitë, datë **.6.2009 në ***. Janë tërhequr më datë **.12.2010, për në shtëpi. Vlera 5.800.000 lekë”.

16.5 Në deklaratat në vijim, subjekti ka deklaruar gjendje cash dhe ndryshime me të, të cilat kanë burim tërheqjen e depozitës së kursimit nga ***⁸.

16.6 Në DV-2016, subjekti ka deklaruar: “Nga gjendja cash e parave në shtëpi është hapur, më datë **.2.2016, depozitë në *** Bank, ku janë derdhur 4.800.000 lekë. Pakësuar gjendja cash në shtëpi: për nevoja të jetës së përditshme -178.011,75 lekë; pushime -330.000 lekë; marrja me qira dhe shpenzime për furnizim për klinikën e bashkëshortes -277.625 lekë”.

16.7 ***, me shkresë nr. ***/* prot., datë **.10.2021, konfirmon se kjo depozitë është çelur në dt. **.6.2003, nëpërmjet depozitimit në cash të vlerës 500.000 lekë dhe shtuar me depozitime dhe tërheqje të tjera ndër vite, nga subjekti dhe/ose i ati (z. ***, ***), si dhe kapitalizim interesash bankare, derisa, në datën **.10.2009, depozita ka pasur vlerën e deklaruar nga subjekti prej 5.400.082 lekë⁹.

16.8 Në lidhje me burimin e krijimit të shumave të depozituara gjatë periudhës 2003 - shtator 2009, nga analiza financiare e Komisionit, në të cilën janë përfshirë të ardhurat e subjektit dhe prindërve të tij për periudhën 1994 - shtator 2009, fillimisht ka rezultuar se prindërit e subjektit të rivlerësimit kanë pasur pamundësi financiare për të krijuar me burime të ligjshme, depozitën bankare në emër të subjektit pranë ***-së, në vlerën totale negative 2.699.775 lekë.

16.9 Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se depozita e kursimit në *** është çelur përpara marrjes së detyrës së subjektit të rivlerësimit dhe i ka kaluar këtij të fundit barrën e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të aneksit të Kushtetutës, për të provuar të kundërtën lidhur me pamjaftueshmërinë e konstatuar.

16.10 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, me prapësimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, ka kundërshtuar analizën financiare të kryer nga Komisioni për periudhën deri shtator 2009 dhe ka kërkuar rishikimin e të ardhurave nga punësimi dhe

⁸ Referohuni deklaratave periodike në dosjen e ILDKPKI-së.

⁹ Në dhjetor 2010, gjendja e depozitës së kursimit është 5.808.831,82 lekë, e cila tërhiqet cash nga subjekti i rivlerësimit. Diferenca e shtesës në depozitë për periudhën tetor 2009 – dhjetor 2010 është shtuar me depozitime nga subjekti i rivlerësimit, të cilat, sipas deklaratimeve në DV- 2010, kanë burim të ardhurat e tij nga paga, tërhequr nga llogaritë e tij pranë *** Bank.

pensionet e prindërve; rishikimin e të ardhurave të të atit nga aktiviteti si avokat¹⁰ dhe të marzhit të fitimit/të ardhurës neto, duke pretenduar në masën 90%¹¹ për periudhën 1998-2009, si dhe rishikimin e të ardhurave nga interesat bankare për periudhën e analizuar, duke pretenduar se, në konsideratë pretendimeve si më sipër, do të rezultonte mjaftueshmëri e burimeve të ligjshme të prindërve për krijimin e depozitave dhe mbulimin e investimeve dhe një tepëriçë pozitive në shumën + 2.504.395 lekë.

16.11 *Komisioni*, pasi ka analizuar pretendimet e subjektit të rivlerësimit dhe aktet e depozituara me prapësimet e tij, ka rishikuar analizën financiare për periudhën e analizuar, bazuar në pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbi të ardhurat e prindërve, marzhin e fitimit nga aktiviteti i avokatisë së të atit, si dhe rishikimin e interesave bankare të periudhës, ka vlerësuar në përfundim se prindërit e subjektit kishin mundësi për krijimin e depozitës në vitin 2003, prej 5.400.082 lekësh, duke zbritur shpenzimet e jetesës dhe investimet e periudhës¹².

16.12 *Komisioneri Publik*, lidhur me analizën financiare të kryer, ndan vlerësim të ndryshëm nga Komisioni si më poshtë:

16.13 Nga vlerësimi i akteve në dosje, *Komisioneri Publik*, fillimisht, vlerëson se fasha mbi të cilën është llogaritur fitimi nga ana e Komisionit për vitet e analizuara është ndjeshëm më e lartë se fitimi i konfirmuar nga organet përgjegjëse për vitet në vijim, 2010-2015,¹³ dhe pamjaftueshmëria financiare në rastin konkret do të shkonte përtej asaj të përlllogaritur nga Komisioni, si më poshtë analizuar:

1) Lidhur me zërin “Të ardhurat nga aktiviteti i të atit si person fizik”

16.14 Komisioni ka vlerësuar se, për vitet 1998-2000 [...] është konsideruar si qarkullim i aktivitetit gjatë kësaj periudhë kohe, vlera 2.000.000 lekë për çdo vit, duke konsideruar se ajo është fasha minimale e të ardhurave nga biznesi për të cilën detyrimet tatimore kanë qenë në administrim të pushtetit vendor (Drejtoria e taksave dhe tarifave vendore, Bashkia Vlorë), për të cilat nuk ka të dhëna të regjistruara nga institucioni për asnjë tatimpagues të kohës, por ndërkohë është provuar kryerja e aktivitetit nga kopja e vendimeve të gjykatës dhe pagesa e sigurimeve vullnetare, për pension, për z. *** ***. Bazuar në të njëjtin arsyetim, Komisioni ka vlerësuar se: [...] për periudhën **2005-2006**, në vijim të sqarimeve të trajtuara më lart (për vitet 1998-2000) e ardhura e përfshirë në analizën e Komisionit është llogaritur me marzh 80% të fashës minimale të qarkullimit, i cili ishte objekt i detyrimeve tatimore të administruara nga pushteti lokal. Në dosjen e administruar përcillet vërtetimi i Bashkisë Vlorë,¹⁴ sipas të cilit, z. *** **, person fizik, ka shlyer detyrimet për taksat dhe tarifat vendore për periudhën 1998-**.**04.2015** [...].

16.14.1 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, për vitet **2005-2006**, nga informacionet e institucioneve përgjegjëse në funksion të hetimit administrativ, si dhe aktet e depozituara nga vetë subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, nuk përcillet informacion për

¹⁰ Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka vënë në dispozicion, ndër të tjera, dhe vërtetimin e ISSH-së nr. ***/* prot., datë **.**9.2023**, si dhe shkresën nr. ***/* prot., datë **.**1.2024**, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë, lidhur me aktivitetin tregtar të të atit të subjektit.

¹¹ Komisioni ka llogaritur marzhin e fitimit në masën 80%.

¹² Referohuni arsyetimit të Komisionit në f. 16-18 të vendimit të arsyetuar.

¹³ Nga aktet në dosje rezulton se qarkullimi për vitin 2010 është në vlerën 440.000 lekë, për vitin 2011 është 171.200 lekë, për vitin 2012 është 45.600 lekë, për vitin 2013 është 31.500 lekë.

¹⁴ Shkresa Bashkia Vlorë nr. *** prot., dt. **.10.2016, Drejtoria e Menaxhimit Financiar, dosja ILDKPKI, aneks **/*, e cila është përcjellë edhe me përgjigjet e pyetësorit dt. 19.9.2019, në dosjen e administruar.

shlyerje detyrimesh tatimore, taksa, pagesa të sigurimeve shoqërore apo edhe të të dhënave të tjera financiare të aktivitetit të të atit për këtë periudhë, në mënyrë që këto të ardhura të plotësojnë kushtet e të ardhurave të ligjshme që mund të përfshihen në analizën financiare të periudhës.

(1) Shkresa nr. ***/* prot. datë **.1.2024, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë, depozituar nga vetë subjekti në përgjigje të barrës së provës, konfirmon pagesat e detyrimeve tatimore për periudhat **1999-2004**, qarkullimin e deklaruar për vitet **2001-2004**, si dhe fitimin për vitet **2010-2015**.

(2) Vërtetimi nr. *** prot., datë **.10.2019, i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave vendore, Bashkia Vlorë, informon mbi xhiro të vlerësuar nga specialisti në shumat 2.000.000 lekë, për vitin **2007**, si dhe xhiro të vlerësuar nga specialisti në shumat 3.000.000 lekë për vitin **2008**, dhe taksat e paguara për këto vite.

(3) Nga aktet e depozituara nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore¹⁵, shkresa nr. ***/* prot. datë **.10.2016 dhe ajo nr. ***/* prot., datë **.10.2016, e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Vlorë, apo informacionit për bazën e vlerësuar të indeksuar ndër vite për ***, ***, (***) , nuk konfirmohet që për vitet 2005-2009 të jenë paguar nga i ati i subjektit kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore si person fizik i vetëpunësuar¹⁶, sikundër konfirmohet për periudhat paraardhëse (viti 2002-2004) dhe ato pasardhëse (2010-2015).

16.14.2 Bazuar në sa më sipër, në vlerësimin e *Komisionerit Publik*, mbetet e paqartë dhe e padokumentuar llogaritja e të ardhurave nga aktiviteti për vitet 2005-2006, në masën 90% të xhiros 2.000.000 lekë në vit, pasi në gjendjen që janë aktet, nuk vërtetohet as kryerja e aktivitetit dhe as pagimi i detyrimeve tatimore me qëllim konsiderimin e të ardhurave të pretenduara, si të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, në këtë periudhë.

16.14.3 Për vitet **2003** dhe **2008**, të ardhurat e llogaritura nga aktiviteti i të atit si person fizik duket se nuk mbështeten në aktet në dosje. Kështu, për vitin 2003, referuar përmbajtjes së shkresës nr. ***/* prot., datë **.1.2023, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë, drejtuar Komisionit, konfirmohet xhiro për aktivitetin në shumën 1.000.000 lekë, ndërsa, sipas përmbajtjes së shkresës nr. ***/* prot., datë **.1.2024, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë, depozituar nga vetë subjekti, në përgjigje të barrës së provës, për të njëjtin vit konfirmohet xhiro prej 1.500.000 lekësh, vlerë të cilën duket se Komisioni e ka marrë në konsideratë në analizën përfundimtare të verifikimit të mundësisë financiare të subjektit dhe personave të lidhur me të. Ndërsa për vitin 2008 rezulton se, referuar përmbajtjes së shkresës së Bashkisë Vlorë nr. *** prot., datë **.10.2019, xhiro e vlerësuar për këtë subjekt (person fizik) është në vlerën 3.000.000 lekë. Ndërkohë, referuar ligjit nr. 9844, datë 17.2.2007, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, nenit 12 të tij, përcaktohet se: [...] *Personat fizikë dhe juridikë, subjekte të taksës vendore mbi biznesin e vogël, sipas kuptimit të nenit 10 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, ... të cilët realizojnë një qarkullim vjetor jo më shumë se 8.000.000 lekë dhe jo më pak se 2.000.000 lekë, janë subjekt i deklarimit të të ardhurave personale [...]. Ç’ka do të thotë*

¹⁵ Si aktet e depozituara nga subjekti në ILDKPKI, ashtu dhe aktet e vëna në dispozicion rishtazi, në kuadër të përmbyesjes së barrës së provës së Komisionit.

¹⁶ Referuar vërtetimit nr. ***/* prot., datë **.10.2016, të ISSH-së Vlorë, dhe të gjitha akteve të dosjes nga ISSH, nuk vërtetohet pagesa e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për këtë periudhë.

se deklarimi dhe raportimi për këtë vit, bazuar në xhiron e vlerësuar, duhej të ishte bërë nga DRT Vlorë dhe jo nga Bashkia, duke vënë në dyshim kështu dhe të ardhurën nga aktiviteti për vitin 2008.

2) Lidhur me zërin “Likuiditetet bankare të prindërve”

16.15 Nga verifikimi i llogarive bankare të prindërve të subjektit konstatohet se, në datën **/9.2010, në llogarinë e rrjedhëse në lekë të të atit të subjektit, pranë ***-së, është kredituar shuma prej 9.914.645 lekë, më përshkrim: [...] *Payment D1 TRF BTH me urdhër të *** nga Payment D2 BSH tek *** dega Vlorë* [...], shumë, e cila, bazuar dhe në informacionin e përcjellë nga DPPPP, me shkresë nr. ***/** prot., datë **/4.2017, dhe aneksit bashkëngjitur, duket se ka qenë e investuar në bono thesari në Bankën e Shqipërisë, që prej shtatorit 2009¹⁷. Ky investim nuk është përfshirë në analizën financiare të Komisionit për periudhën deri në shtator 2009. Në rast të përfshirjes së kësaj shume në analizën financiare, pamjaftueshmëria financiare do të rritej ndjeshëm, përtej asaj të konstatuar nga Komisioni¹⁸.

16.15.1 Gjithashtu, ***, me shkresën nr. ***/** prot., datë **/10.2023, konfirmon dhe llogari bankare dyemërore në emër të nënës së subjektit dhe shtetases ***. ***, llogari në të cilat, për periudhën e analizuar, konstatohet se ka depozitime *cash*, në vlerën 4.700.000 lekë, me përshkrim: “*** *** *derdh në llogari*”, për të cilat nuk duket se ka informacion mbi burimin.

3) Lidhur me zërin “Shpenzime jetese”

16.16 Nga analizimi i zërave përbërës të analizës financiare të kësaj periudhe, rezulton se shpenzimet e jetesës për vitin 2007, për subjektin dhe prindërit, Komisioni, në analizën financiare të këtij viti, i ka llogaritur jo në përputhje me standardin e përdorur në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, bazuar në korrespondencën me ILDKPKI-në¹⁹.

16.17 Në përfundim për gjithë sa më sipër, në vlerësimin e *Komisionerit Publik*, edhe në konsideratë të llogaritjes së marzhit të fitimit sipas pretendimeve të subjektit në masën 90% të fashës minimale të qarkullimit të konfirmuar, nga analiza financiare e periudhës 1994-2009, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë burimet e ligjshme të krijimit të depozitës bankare, deklaruar në Deklaratën “Vetting”, si dhe kursimeve në *cash*.

16.18 *Komisioneri Publik* vendos në vëmendje se, në një interpretim të dispozitave të zbatueshme lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë, sipas qëllimit të procesit të rivlerësimit kalimtar, të përcaktuar në nenin 179/b, pika 1 e Kushtetutës dhe në nenin 1 të ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka një jurisprudencë të konsoliduar dhe ka arritur në konkluzionin se²⁰, nëpërmjet procedurës së kontrollit të pasurive, synohet identifikimi i atyre subjekteve të rivlerësimit, të cilët janë bërë përfitues apo përdorues të pasurive në mënyrë të paligjshme apo me të ardhura, ligjshmëria e të cilave, referuar standardit të përcaktuar në nenin D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, vihet në dyshim, pavarësisht nëse ky fakt nuk lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë

¹⁷ Në shkresën e DPPPP-së, për ILDKPKI-në, konfirmohet në datën **/9.2009, shuma 10.002.000 lekë, referuar të dhënave në këtë akt.

¹⁸ Në analizën financiare të kryer duket se ndryshimi i likuiditeteve në llogaritë bankare të prindërve për periudhën shtator 2009-dhjetor 2008 është llogaritur në vlerën 3.563.516 lekë dhe nuk është përfshirë shuma prej 10.002.000 lekë, e cila duket se është investuar pikërisht gjatë kësaj periudhe.

¹⁹ Referohuni vendimit të Kolegjit (JR) nr. 18/2022, prg. 27.1.

²⁰ Referohuni vendimit (JR) nr.19/2019; vendimit (JR) nr. 8/2019; vendimit (JR) nr.13/2020; vendimit (JR) nr. 12/2020.

me ushtrimin e detyrës së subjektit, apo rezulton të ketë ndodhur jashtë periudhës kohore të ushtrimit të saj.

17. Apartament banimi në përdorim

17.1 Në *D-Vetting*, subjekti ka deklaruar: “*Banoj në apartamentin me adresë Tiranë, rruga *** ***, hyrja **, apartamenti **, nr. pasurie */***+***, me sip. 93,51 m², blerë nga prindërit nga kursimet e tyre në datën **.1.2014, kundrejt çmimit 72.270 euro. Ky apartament më është dhënë në përdorim nga prindërit. Vlera 72.270 euro. Pjesa takuese: 0%*”.

17.2 Në DV-2015, subjekti ka deklaruar: “*Prej pranverës së vitit 2015 banoj në apartamentin në pronësi të prindërve të mi te pallati *** (adresa në faqen 1 të këtij deklarimi). Për mobilimin dhe elektroshtëpiaket kam harxhuar nga gjendja cash shumën 1.000.000 lekë (s qarime për këtë shpenzim kam dhënë para ILDKPKI në procesverbalet e datave **.02.2016 dhe **.02.2016)*”.

17.3 Sipas akteve në dosje të Komisionit ka rezultuar, ndër të tjera, certifikatë për vërtetim pronësie të datës **.1.2015 dhe kartelë pasurie për apartament me sip. 93,51 m², ndodhur në rrugën “**** **”, Tiranë, sipas së cilës rezulton se apartamenti është regjistruar në emër të znj. ***. ***. (nëna e subjektit)²¹.

17.4 Nga korrespondenca e Komisionit me ASHK, Drejtoria Vendore Tirana Jug dhe Tirana Rurale informohet se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk disponojnë pasuri, ndërsa Drejtoria Vendore Tirana Veri, me shkresë nr. ***/* prot., datë **.9.2023, konfirmon vetëm pasurinë “garazh” në emër të subjektit të rivlerësimit, ndërsa për personat e tjerë (prindërit dhe bashkëshorten) konfirmon se nuk figurojnë pasuri të regjistruara. Nuk rezulton të jetë verifikuar mungesa e të dhënave kadastrale për këtë pasuri të paluajtshme.

17.5 Komisioni, referuar nenit D të aneksit Kushtetues, për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit është subjekt kontrolli për krijimin e pasurisë në përdorim, *apartament 93,51 m²*, blerë në vitin 2014 nga prindërit e tij, referuar pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, “*Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, duke mbartur detyrimin e justifikimit të ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurisë *apartament me sip. 93,51 m²*, blerë nga prindërit e tij, në vitin 2014, dhe mundësinë financiare për krijimin e kësaj pasurie.

17.6 Nga hetimi administrativ ka rezultuar se ***, me shkresë nr. ***/** prot., dt. **.10.2023, konfirmon se, në dt. **.1.2014, është transferuar shuma 70.000 euro, nga llogaria dyemërore e shtetasve *** dhe *** ***, me përshkrim: “**** ose *** ** sa kaluar në favor të *** shpk për blerje apartamenti sipas kontratës së porosisë për apartamentin */**, kati * (2+1)”²². Shuma 70.000 euro është depozituar në *cash* nga nëna e subjektit të rivlerësimit,

²¹ Shuma e shlyer për këtë pasuri ka qenë 72.270 euro; (ii) Kontratë porosie nr. *** rep., nr. ** kol., datë **.1.2014, përcjellë nga subjekti me Deklaratën “Vetting”, sipas së cilës rezulton se prindërit e subjektit me anë të kësaj kontrate kanë porositur apartamentin me sip. totale 104,26 m² (sipërfaqe të brendshme 93,51m²), në vlerën 72.982 euro, e cila parashikohej të likuidohet: kësti i parë, me vlerë 70.000 euro, likuidohet nga porositësi, me nënshkrimin e kontratës dhe me dorëzimin e çelësave të apartamentit, do të likuidohet kësti i dytë dhe i fundit me vlerë 2.982 euro; (iii) Kontratë shitje e pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.12.2014, sipas së cilës, vlera e blerjes së apartamentit prej 72.270 euro, e cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale sipas kontratës së porosisë; (iv) Një deklaratë (të thjeshtë), datë **.5.2015, të shtetasve ***, dhe ***, ***, për lënien e apartamentit për banim djalit të tyre, Gentjan Habazaj, pasi ata kanë një apartament tjetër për të banuar dhe pasuri të tjera të paluajtshme.

²² Pagesa e këstit të fundit është bërë me depozitim *cash* në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k., konfirmuar nga kjo e fundit, në dt. **.12.2014, nga znj. *** ***, me përshkrim: “Sa derdh për *** sh.p.k., kësti i fundit për blerje apartamenti 2/35, sip. 104.26 m² (2+1).”

konkretisht vlera 12.000 euro, në dt.**.1.2014, me përshkrim: “*Të ardhura nga puna*” dhe vlera 58.000 euro, në dt. **.1.2014, vlerë e cila është vlerësuar nga Komisioni si e krijuar nga prindërit e subjektit të rivlerësimit nga gjendje *cash* dhe likuiditete në bankë të disponuar prej tyre dhe pjesërisht prej shumës së marrë kredi nga nëna e subjektit pranë bankës ***²³. Nga aktet e administruara rezultojnë se, me kontratë kredie bankare, datë **.1.2014, prindërit e subjektit kanë përfituar nga *** kredinë në shumën 5.000.000 lekë, e cila është siguruar nëpërmjet depozitës bankare në njëjtën bankë, në shumën 10.000.000 lekë. Shuma e përfituar e kredisë është tërhequr në *cash*, në datën **.1.2014 dhe në datën **.3.2014 është mbyllur kredia së bashku me interesat nëpërmjet depozitës së maturuar në të njëjtën bankë.

17.7 Komisioni ka vlerësuar të kryejë analizën financiare për burimin e krijimit të apartamentit, duke filluar nga viti 2010, pasi nga analiza financiare e trajtuar më sipër rezultojnë se, deri në fund të vitit 2009, rezultati financiar është me vlerë negative. Komisioni ka konstatuar se, gjatë periudhës kohore 2010-2013, prindërit e subjektit të rivlerësimit kanë kryer edhe investime të tjera, konkretisht kanë investuar në blerjen edhe të 3 pasurive të tjera, të cilat, në vlerë totale, kanë qenë në shumën 253.860 euro; kanë shtuar likuiditetet e tyre në sistemin bankar, të cilat përlllogariten në shumën totale 26.649.435 lekë, si dhe nga dosja e administruar e një tjetër subjekti të rivlerësimit, ka rezultuar se në këtë kohë (*viti 2011*) është bërë edhe dhurimi i shumës 42.000 euro nga prindërit e subjektit, me burim të deklaruar: “*kursime familjare*”, ndërsa të ardhurat e prindërve të subjektit, gjatë periudhës 2010-2012, janë në vlerën 3.701.026 lekë²⁴.

17.8 Komisioni ka hartuar analizën financiare të prindërve të subjektit të rivlerësimit për krijimin e pasurisë *apartament banimi në përdorim*, duke u mbështetur në vendimmarrjen e deritanishme dhe qëndrimet e konsoliduara të mbajtura nga Kolegji²⁵, në të cilat orientohet Komisioni: [...] Kolegji²⁶ çmon se në rastet kur subjekti i rivlerësimit gjendet para situatës së parashikuar prej nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ai duhet të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të asaj pasurie, pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjitha pasuritë që kanë personat e tjerë të lidhur [...] dhe në përfundim i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të aneksit të Kushtetutës, pasi duket se prindërit e tij nuk kishin mundësi financiare për të blerë me të ardhura të ligjshme

²³ Komisioni ka arsyetuar se: [...] në dt.**.01.2014, prindërit e subjektit të rivlerësimit kanë tërhequr shumën 3.013.611,77 lekë nga llogaria e depozitës së kursimit në monedhën lekë, pranë bankës ***; depozitë e cila rezultojnë të jetë çelur prej tyre në dt. **.11.2002 dhe prindërit e subjektit të rivlerësimit kanë kryer depozitime dhe tërheqje të herëpashershme në të, duke rezultuar me vlerë prej 15.500.000 lekë deri në dt. **.03.2013. Kjo gjendje duket se krijohet nga transferimi i vlerës së depozitës të çelur më herët pranë *** Bank, ku gjendja e saj në dt. **.03.2013, prej 12.732.400 lekë, është transferuar në llogarinë dyemërore të prindërve, në të cilën janë tërhequr fondet dhe më pas konvertuar dhe ridepozituar në llogarinë e tyre në euro, duke transferuar te shoqëria ndërtuese, veprime të kryera nga nëna e subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, depozitimi i vlerës së mbetur (për të plotësuar 15.500.000 lekë në dt. **.03.2013) prej 3.349.721,13 lekë vjen nga tërheqja e shumës 22.082,84 euro, në po këtë datë, **.03.2013, e depozitës në euro në llogarinë dyemërore të prindërve. Kjo depozitë është krijuar në dt. **.07.2007, nga depozitimet e prindërve dhe gjendja e saj prej datës **.10.2008 ka qenë 22.225 euro. Ndërsa, në dt. **.01.2014, znj. *** *** tërheq cash vlerën e kredisë bankare të marrë pranë *** sha, prej 5.000.000 lekë (ose rreth 35.686 euro), kredi e cila më pas shlyhet me fondet e depozitës së kursimit pranë kësaj banke (në dt. **.03.2014) [...].

²⁴ Komisioni ka vlerësuar se, nëse do të konsiderohen në analizën financiare edhe konstatimet sa më lart, për periudhën 2010-2012, për prindërit e subjektit, atëherë të ardhurat e disponueshme për t'u përfshirë në analizën financiare të krijimit të apartamentit do të ishin vetëm rezultati i vitit 2013, të cilat janë në vlerën 985.114 lekë, të pamjaftueshme për të përballuar pagesat për apartamentin dhe shpenzimet e jetesës në këtë vit. Duke marrë parasysh arsyetimet e mësipërme, analiza e apartamentit do të hartohej duke konsideruar si burim të ligjshëm vetëm vlerën e kursimeve të vitit 2013, në shumën 730.048 lekë, e cila është e pamundur të mbulojë vlerën e pagesës së apartamentit në shumën e konvertuar 10.250.749,7 lekë, duke rezultuar pamundësi financiare në shumën -9.422.683,7 lekë (prg. 2.25 i vendimit).

²⁵ Vendim (JR) nr. 1/2023; Vendim (JR) nr. 2/2023.

²⁶ Vendim (JR) nr. 15/2019 i Kolegjit.

apartamentin pranë shoqërisë “***” sh.p.k., duke rezultuar me pamundësi në vlerën 3.009.125 lekë²⁷.

17.9 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ, ka pretenduar se ky apartament i takon të ëmës së tij dhe, në asnjë moment, nuk ka qenë në pronësi të tij, për rrjedhojë, qëndrimi procedural për këtë barrë provë është se nuk është i detyruar të japë asnjë shpjegim në lidhje me të ardhurat e prindërve të tij, për të cilët ka vlerësuar se nuk janë persona të lidhur, në kuptim të pikës 13, të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016 dhe as persona të tjerë të lidhur, në kuptim të pikës 14, të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016. Për aq kohë sa Komisioni nuk i ka kaluar barrë prove për fshehje pasurie, subjekti ka deklaruar se proceduralisht nuk jep shpjegime në referim të pikës 4, të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016.

17.9.1 Gjithsesi, lidhur me pamjaftueshmërinë financiare të konstatuar nga Komisioni, subjekti ka pretenduar se prindërit e tij kanë zotëruar pranë ***-së depozitën dyemërore në lekë, çelur më **.11.2002, kohë kur subjekti i rivlerësimit ka qenë student në universitet, ndërkohë që është emëruar prokuror në stazh në datën **.10.2009 dhe është emëruar prokuror me Dekretin nr. ***, datë **.11.2010, duke shpjeguar dhe zanafillën e kësaj depozite. Subjekti ka kundërshtuar analizën financiare, lidhur me faktin se për depozitim e shumës 12.000 euro, datë **.1.2014, disponuar *cash* në banesë nga prindërit e subjektit, si burim krijimi kanë shërbyer të ardhurat nga aktiviteti i të atit për periudhën 1998-2014, të ardhura të prindërve nga pagat dhe pensionet, si dhe të ardhurat nga interesat e depozitave bankare të përfituara nga investimet e prindërve. Ndërsa për dy depozitimet e tjera, subjekti ka pretenduar se si burim kanë shërbyer të ardhurat nga kredia bankare pranë ***-së, si dhe të ardhurat nga tërheqjet nga llogaria bankare e të ëmës pranë ***-së, në datën **.1.2014²⁸.

17.9.2 Në mënyrë të përmbledhur, subjekti ka kundërshtuar analizën financiare të kryer nga Komisioni dhe ka kërkuar rishikimin zërave përbërës të saj, si interesat bankare të përfutur për investimet e prindërve në sistemin bankar deri në atë moment, mundësisë së kursimit të prindërve të tij për periudhën deri në vitin 2009 (sipas analizës së tij) si dhe përfshirjen e të ardhurave të të ëmës si rezultat i ekzekutimit të një vendimi gjyqësor.

17.10 Komisioni, në përfundim, ka vlerësuar se prindërit e subjektit kanë rezultuar me mundësi financiare për blerjen e apartamentit në përdorim të subjektit, pasi ka marrë në konsideratë faktet dhe provat si vijon:

- *Vlerat e interesave të depozitës së kursimit kanë qenë më të larta se interesi i kredisë, e konfirmuar kjo nga përgjigjet e ***-së, interesi i kredisë ishte 50.940 lekë (për periudhën 2-mujore) dhe interesi i depozitës së kursimit ishte në total 707.840 lekë.*

- *U provua me dokumentacionin bankar të ***-së dhe *** Bank të ardhurat e nënës nga ekzekutimi i vendimit të gjykatës, si dhe shpërndarja nga KESH e të ardhurave si ortakë.*

- *U përfshinë në analizën financiare të ardhurat nga depozitat bankare të prindërve për periudhën 2010 – 2013 pranë *** dhe ***-së. Vlerat e shpjeguara nga subjekti në prapësime përputhen me statementin bankar të bankave të përcjella në Komision.*

16.10.1 Komisioni ka kryer analizën financiare të mundësisë së prindërve të subjektit për periudhën 2010 – 2013, duke bërë përditësimet e saj sipas konkluzioneve me sipër, dhe

²⁷ Vlera e apartamentit 10.125.750 lekë – 5.000.000 lekë vlera e kredisë – 2.116.625 lekë vlera e kursimeve të mundshme.
²⁸ Referohuni prapësimeve të subjektit të rivlerësimit.

pretendimeve të subjektit, duke përfshirë edhe kredinë bankare prej 5.000.000 lekësh dhe rezultatin e analizës financiare kumulative për periudhën 1994 – shtator 2009²⁹.

17.11 *Komisioneri Publik*, për sa më sipër, nisur nga rrethanat konkrete të verifikuara në këtë rast, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit dhe aktet e administruara në dosje, ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni mbi vlerësimin e situatës faktike në raport me legjislacionin e zbatueshëm, duke trajtuar si persona të tjerë të lidhur prindërit e subjektit, sipas pikës 4, të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016.

17.11.1 Në këtë kontekst, Komisioneri Publik gjen me vend të theksojë dhe orientimin e Kolegjit në jurisprudencën e tij, mbi mënyrën e arsytimit, në drejtim të nevojës për kualifikimet e duhura ligjore të situatave faktike, veçanërisht në funksion të të provuarit të shkaqeve të përdorura për shkarkimin e subjekteve, në lidhje me cilësimin e personit/personave të tretë, si person/persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, apo të marrëdhënies konkrete të subjekteve të rivlerësimit me pasuritë e caktuara³⁰.

17.11.2 *Komisioneri Publik* vlerëson, nisur nga rrethanat e provuara gjatë hetimit administrativ të Komisionit në rastin konkret, lidhur me faktet, se:

(i) Prindërit e subjektit të rivlerësimit, sikundër konstatuar dhe nga vetë Komisioni, kanë rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme financiare për të investuar në këtë pasuri, si dhe pasuri të tjera të rezultuara gjatë hetimit administrativ, investime të cilat rezultojnë se janë raportuar si të dyshimta në agjencitë ligjzbatuese nga ana e DPPP-së.

(ii) Kjo pasuri rezulton e përdorur vetëm nga subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij, që nga momenti i blerjes së saj e në vijim.

(iii) Nëna e subjektit të rivlerësimit ka blerë pasurinë *apartament me sipërfaqe 93,51 m²* në vlerën 72.270 euro, në vitin 2014.

(iv) Nga aktet në dosje konfirmohet se prindërit e subjektit të rivlerësimit, për periudhën deri në janar 2014 (moment kur janë shlyer pagesat për blerjen e apartamentit), kanë kryer investime të tjera në pasuri të luajtshme, konkretisht dhe dy apartamente të tjera në Tiranë dhe një në Orikum (përlllogaritur në një vlerë prej rreth 251.860 euro³¹ në total). Në fund të vitit 2013, prindërit e subjektit posedojnë kursime në llogaritë bankare në një vlerë prej rreth 43.000.000 lekë³². Nga aktet në dosje ka rezultuar se gjatë kësaj periudhe (viti 2011), babai i subjektit ka dhënë dhe një shumë hua, e cila, më vonë, deklarohet e dhuruar, në vlerën 42.000 euro. Nga hetimi ka rezultuar se investimet e prindërve në pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme janë ndjeshëm më të larta se të ardhurat e ligjshme të tyre, të konfirmuara nga institucionet përgjegjëse për periudhën 2010-2013. Investimet rezultojnë ndjeshëm më të larta edhe në raport me të ardhurat totale të prindërve, nisur që nga viti 1994.

17.11.3 Në këto rrethana, Komisioni do të duhej ta kishte interpretuar nevojën për të argumentuar këtë marrëdhënie pasurore, në raport me legjislacionin e zbatueshëm, për të arritur në një konkluzion në kuadër të nenit D, pika 5 e aneksit të Kushtetutës.

²⁹ Referohuni arsytimit të Komisionit dhe analizës në formë tabelore, në f. 28-29 të vendimit të arsytuar.

³⁰ Vendim (JR) nr. 21/2020, prg. 77 i Kolegjit.

³¹ Blerë apartament me sip. 101.86 m² me vlerë 101.860 euro, me kontratë sipërmarrje nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.4.2010, në Tiranë, blerë apartament me sip. 125 m² me vlerë 125.000 euro, me kontratë sipërmarrje, datë **.4.2010, në Tiranë, blerë apartament me sip. 47,48 m², më vlerë 27.000 euro (nga të cilat 25.000 paguar brenda periudhës së analizuar), me kontratë nr. *** rep., nr. ***/* kol., datë **.6.2015, Orikum, Vlorë.

³² Balancat e llogarive bankare më datë **.12.2013, e cila në fund të vitit 2014 llogaritet në vlerën rreth 35.000.000 lekë, shtuar me një diferencë prej rreth 9.700.000 lekë nga viti 2009.

17.11.4 Bazuar në sa më sipër, gjendet i pambështetur arsyetimi dhe konkluzioni i Komisionit, mbi analizimin e burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, duke analizuar vetëm pasurinë e blerë nga prindërit e subjektit. në vlerën 72.270 euro, periudhën 2010-2013, duke përfshirë në mesin e burimeve të ligjshme të ardhurat nga pagat, pensionet, interesat bankare, dhe kredinë në shumën 5.000.000 lekë³³, dhe duke zbritur vetëm shpenzime jetese për prindërit e subjektit për të njëjtën periudhë. Për sa trajtuar dhe analizuar më sipër në trajtimin e pasurisë nr.1, i pambështetur gjendet dhe përfshirja nga Komisioni në analizën e periudhës 2010-2013, të shumës prej 1.067.952 lekë,³⁴ si mundësi kursimi e ardhur nga rezultati financiar i analizës së prindërve, për periudhën 1994 – shtator 2009.

18. Në përfundim, *Komisioneri Publik*, në analizë të gjithë sa trajtuar më sipër mbi investimet e konsiderueshme të prindërve të subjektit të rivlerësimit, në raport me të ardhurat e ligjshme të provuara referuar nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, vlerëson se analiza e kryer nga Komisioni për këtë pasuri nuk mbështetet në aktet në dosje dhe subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë bindshëm burimet e ligjshme të pasurisë në përdorim dhe mbulimin e investimeve të tjera të periudhës. Si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm, sipas parashikimeve të nenit D të aneksit të Kushtetutës.

III. B Për vlerësimin e aftësive profesionale

19. Hetimi i Komisionit, lidhur me kriterin e aftësive profesionale, është bazuar në administrimin e të gjithë burimeve të vlerësimit, ndër të tjera, dhe në vlerësimin e denoncimeve të paraqitura dhe shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, që lidhet me çështjet objekt ankimi nga subjektet denoncuese.

20. Në vijim të përfundimeve të arritura nga Komisioni, në shqyrtim të shkaqeve të denoncimeve, nisur dhe nga fakti që jurisprudenca e Kolegjit ka theksuar rëndësinë që ka në procesin e rivlerësimit, vlerësimi i denoncimeve nga publiku dhe rritja e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, Komisioneri Publik çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse, mbi gjetjet e rezultuara nga burimet e administruara, të cilat duhet të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për sa trajtuar në vijim:

21. Denoncim i shtetases * **35**

21.1 Kjo shtetase ka denoncuar edhe më parë subjekte të tjera pranë Komisionit, në lidhje me çështjen e pronës së saj dhe trashëgimtarëve të tjerë të familjes së saj. Në denoncimin e datës **.10.2018, denoncuesja, ndër të tjera, ngre pretendime mbi vendimin e subjektit të rivlerësimit për mosfillimin e kallëzimit penal nr. ***, datë **.1.2020. Ky kallëzim lidhet me denoncimin e bërë nga shtetaset ***, ***, dhe ***, ***, për shtetasin ***, ***, me detyrë shëf i Komisarariatit të Policisë Skrapar, pasi pretendojnë kryerjen e veprimeve të paligjshme nga ky i fundit.

21.2 Kjo shtetase, në denoncimin e saj, ndër të tjera, pretendon se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, e ka dërguar çështjen për kompetencë në SPAK³⁶ dhe

³³ Kredi, e cila rezulton se është shlyer vetëm dy muaj pas marrjes, si e tillë është pjesë integrale e likuiditeteve të analizës.

³⁴ Referohuni analizës financiare në tabelën e paraqitur në f. 29 të vendimit të arsyetuar.

³⁵ Me nr.*** prot., datë **.10.2018.

³⁶ Denoncuesja referon shkresën me nr. ***/* prot., datë **.1.2020.

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar e ka kthyer³⁷ materialin sërish në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Berat, me arsyetimin se nuk ka kryerje të veprës penale të korrupsionit aktiv të personave që ushtrojnë funksion publik, parashikuar nga neni 259 i K. Penal. Nga denoncuesja pretendohet se Prokuroria Berat hodhi poshtë denoncimin e tyre për korrupsion dhe shpërdorim detyre.

21.3 Komisioni, nisur nga pretendimet e denoncueses, ka arsyetuar që, duket se subjekti i rivlerësimit, referuar konstatimeve të SPAK-ut, në cilësinë e prokurorit, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal nr. ***/2019. Sa më sipër i ka kërkuar subjektin të rivlerësimit [...] shpjegime në lidhje me arsyen e dërgimit për kompetencë pranë SPAK të procedimit penal të sipërcituar dhe arsyet që kanë çuar subjektin të vendosë më pas mosfillimin e këtij procedimi penal të kthyer [...].

21.4 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, është shprehur se: [...] ***, ***, dhe ***, ***, janë dy shtetase që, për të njëjtin fakt, problem pronësie, kanë bërë kallëzime penale të vazhdueshme, duke u ankuar ndaj vendimmarrjeve të të gjithë prokurorëve dhe gjyqtarëve pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Berat. Në lidhje me kallëzimin penal nr. *** të vitit 2019 të këtyre shtetaseve, nga ana ime, në datën **.1.2020, është vendosur mosfillimi i procedimit penal. Në vendim arsyetohet se...denoncimi për shtetasin ***, ***, për veprat penale “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike” dhe “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga nenet 244 dhe 259 të Kodit Penal, bazuar në nenin 75/a dhe nenin 84 të Kodit të Procedurës Penale, janë kompetencë e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar Tiranë dhe, me shkresën nr. ***/* prot., datë **.1.2020, ia kemi dërguar për kompetencë kësaj Prokurorie. Me shkresën nr. **/* prot., ***, ***, datë **.1.2020, kjo Prokurori e ka kthyer materialin sërish në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, me arsyetimin se nuk kemi kryerje të veprave penale të parashikuara nga nenet 244 dhe 259 të Kodit Penal **dhe nuk konstatohen elemente të ndonjë veprë tjetër penale.** Në bazë të neneve 89 dhe 28, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale, kur ka mosmarrëveshje për kompetencë, Prokuroria e Shkallës së Parë është e detyruar të pranojë zgjidhjen që i ka dhënë Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar Tiranë. **Në rastin e kallëzimit të ***, ***, kjo Prokurori nuk ka konstatuar ndonjë veprë tjetër penale, për të cilën të orientonte hetimin. Proceduralisht duhej që vetë Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar të vendoste mosfillim të procedimit penal, por për shkak se materialin ia ktheu Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Berat, i ngelej Prokurorisë së Rrethit Berat të vendoste për mosfillimin e procedimit penal, ku dhe kam vendosur mosfillimin e procedimit penal brenda afatit 15-ditor, të parashikuar në nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale.** Në datën **.5.2021 jam transferuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe nuk ishte më përgjegjësi e imja ndjekja e këtij procedimi, i cili është regjistruar me nr. ***, datë **.1.2023, nga një prokuror tjetër, për shkak të vendimit të Gjykatës së Apelit për veprën penale “Shkatërrimi i pronës”, parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal, veprë penale e ndryshme nga pretendimi i kallëzimit. Ky procedim penal është në fazë hetimi dhe ndiqet nga prokurorë të tjerë [...].

³⁷ Denoncuesja referon shkresën me nr. **/* prot., datë **.1.2020.

21.5 Në përfundim të prapësimeve të subjektit dhe akteve të vëna në dispozicion nga subjekti, Komisioni në vendimin e tij ka përmbledhur dhe arsyetuar përfundimisht qëndrimin mbi denoncimin konkret, duke u shprehur vetëm që: [...]shpjegimet e paraqitura për ankesën e datës **.10.2018, nga subjekti i rivlerësimit ishin të mjaftueshme dhe bindëse [...], pa e arsyetuar dhe mbështetur atë mbi faktet që janë administruar në rastin konkret.

21.6 Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka finalizuar shkurtimisht Komisioni, duke mbajtur në konsideratë dhe rëndësinë e arsyetimit të vendimeve, si një garanci për procesin e rregullt ligjor³⁸, vlerëson se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse dhe nuk mbështeten në aktet në dosje, për sa rezulton në vijim:

1) Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Berat, mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasve ***. ***. dhe ***. ***, në datën **.12.2019, ka regjistruar kallëzimin penal nr. ***/2019, kundrejt shtetasve ***. ***, për veprat penale të “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 i K. Penal. Meqenëse këto vepra, bazuar në nenin 75/a të K. Pr. Penale, janë në kompetencë të SPAK-ut, me shkresën nr. ***/*, datë **.1.2020, ky denoncim i është dërguar për kompetencë kësaj prokurorie.

2) SPAK, me shkresën nr. **/* prot. ***. ***, datë **.1.2020, ka ridërguar për kompetencë aktet e materialit hetimor nr. ***/2019, duke arsyetuar se: [...] pasi nga verifikimi i akteve të këtij materiali hetimor nuk rezulton ndonjë e dhënë se janë konsumuar elementët e veprave penale të parashikuara nga nenet 224 dhe 259 i K. Penal. Sa më sipër, bazuar në nenet 28/3,74 dhe 76, të K. Penal, po ju ridërgojmë për kompetencë aktet e materialit hetimor nr. ***, datë **.12.2019, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Berat [...].

3) Subjekti i rivlerësimit, më datë **.1.2020, në bazë të neneve, 290 prgr.1, germa “ç”, 291 të K. Pr. Penale, ka marrë vendimin për mosfillimin e procedimit penal të materialit kallëzues me nr. ***/2019, ndër të tjera, duke arsyetuar se në rastin konkret, SPAK: [...] nuk ka konstatuar elementë të veprave penale të “Korrupsionit aktiv të personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 244 dhe “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 i K. Penal, dhe nuk konstatohen elementë të ndonjë veprave penale [...].

4) Ky vendim është ankimuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Berat, e cila, me vendimin nr.***, datë **.5.2021, ka vendosur shfuqizimin e vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Berat, “Për mosfillimin e çështjes penale që i përket kallëzimit penal nr. ***/2019 dhe detyrimin e Prokurorisë për vazhdimin e hetimeve, pasi të ketë regjistruar procedimin penal, pasi: [...] Gjykata konstaton se ka elementë të veprës penale të “Shkatërrimi i pronës”... dhe në rast se rezulton se kjo shoqëri ka punuar pa dokumentacionin përkatës, përveç sa më sipër, mund të kemi elementë të veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”...jo vetëm nga personi i kallëzuar, por dhe nga të gjithë personat që në bazë të ligjit kanë pasur për detyrë kontrollin e dokumentacionit përkatës [...].

5) Ndaj këtij vendimi ka ushtruar ankim Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Berat, e përfaqësuar në seancë nga prokurori pranë Gjykatës së Apelit Vlorë. Gjykata e Apelit

³⁸ Shihni vendimet nr. 3, datë 26.1.2015, nr. 63, datë 23.9.2015, nr. 24, datë 25.4.2016, nr. 73, datë 16.12.2016, të Gjykatës Kushtetuese.

Vlorë, me vendimin nr. *** datë **.10.2021, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.*** datë **.5.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Berat. Gjykata e Apelit, në vendimin e saj, ndër të tjera, ka arsyetuar se: [...]Edhe pse kallëzimi i kallëzuesve, për të cilin Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Berat ka vendosur mosfillimin e procedimit penal nr.5166/2019, është bërë për veprat penale “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 244 dhe “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 i K. Penal, vepra për të cilat nuk u gjetën elementë të ekzistencës së tyre, kjo nuk e pengon organin e akuzës që të shtrijë hetimin edhe për vepra të tjera penale për të cilat ajo është kompetente... Pra organi i akuzës ka një rol proaktiv në kryerjen e një hetimi, në zbulimin e veprave penale, autorëve të këtyre veprave dhe vënien e tyre përpara përgjegjësisë. Ajo nuk është e kufizuar në faktet dhe bazën juridike të vendosura në themel të kallëzimit. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Berat, edhe kryesisht, duhet të kishte verifikuar rregullsinë e lejeve përkatëse për kryerjen e veprimtarisë nga ana e shoqërisë “*** ***” sh.p.k., në vendin në të cilin ndodhet prona e pretenduar nga ana e kallëzuesve. Në të njëjtën kohë duhet të hetojë edhe nëse veprimtaria e shoqërisë “*** ***” sh.p.k. është duke u kryer ose jo në kundërshtim me urdhrin nr.***, datë **.5.2018, të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, me të cilin është vendosur pezullimi i lejes mjedisore të shoqërisë. Së fundi, ajo duhet të hetojë edhe mbi veprën penale “Shkatërrimi i pronës”... Gjithashtu, Gjykata e Apelit çmon të tërheqë vëmendjen prokurorit, i cili ka paraqitur ankimin ndaj vendimit nr.***/2019, të Gjykatës së Shkallës së Parë, Berat, për gjuhën joprofesionale dhe ironike kundrejt gjykatës, të përdorur në ankim. Shprehje të tilla të përdorura si: “Gjykata ka për detyrë të japë drejtësi dhe të jetë e paanshme, duke mos u tulatur përpara intonacionit të zërit të palëve apo frikës nga ndonjë ankesë e tyre kundër trupit gjykues”, janë të papajtueshme me gjuhën që duhet të ketë një magjistrat në aktet procedurale të përgatitura prej tij. Prokurori ka të drejtë të paraqesë ankim ndaj vendimit të gjykatës, nëse nuk pajtohet me qëndrimin e saj, por jo të ngrejë insinuata dhe të shprehet në mënyrë ironike në ankim [...].

21.7 Komisioneri Publik, lidhur me pretendimin e subjektit që SPAK e ka kthyer materialin sërish në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Berat, me arsyetimin se nuk kemi kryerje të veprave penale të parashikuara nga nenet 244 dhe 259 të Kodit Penal **dhe nuk konstatohen elemente të ndonjë veprave tjetër penale**, vëren se SPAK ka ridërguar për kompetencë aktet e materialit hetimor nr.***/2019, pasi ka vlerësuar se në të nuk ka të dhëna për vepra penale në kompetencën e kësaj Prokurorie, por jo që ky material hetimor nuk përmban elemente të ndonjë vepër penale.

6) Subjekti referon se, në bazë të të neneve 89 dhe 28, pika 3 e K. Pr. Penale, kur ka mosmarrëveshje për kompetencë, Prokuroria e Shkallës së Parë është e detyruar të pranojë zgjidhjen që i ka dhënë Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë. [...] Në rastin e kallëzimit të ***. ***, kjo Prokurori nuk ka konstatuar ndonjë vepër tjetër penale, për të cilën të orientonte hetimin. Proceduralisht duhej që vetë Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të vendoste mosfillim të procedimit penal, por për shkak se materialin ia ktheu Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Berat, i ngelej Prokurorisë së Rrethit Berat të vendoste për mosfillimin e procedimit penal, ku dhe kam vendosur mosfillimin e procedimit penal brenda afatit 15-ditor, të parashikuar në nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale [...].

7) *Komisioneri Publik* vlerëson se prapësimet e subjektit nuk mbështeten as në bazën ligjore të zbatueshme. Neni 28/3 i K. Pr. Penale përcakton se kur Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, pasi i shqyrton aktet, vendos pranimin e tyre ose i ridërgon ato në prokurorinë e mëparshme, kjo e fundit ka detyrimin të pranojë aktet. Fakti që Drejtuesi i Prokurorisë është shprehur se nga verifikimi i akteve të këtij materiali hetimor nuk rezulton ndonjë e dhënë se janë konsumuar elementet e veprave penale të parashikuara nga nenet 224 dhe 259 i K. Penal, nuk nënkupton që nuk ka elemente të ndonjë vepre tjetër penale. Prokuroria e mëparshme është e detyruar të pranojë aktet, por jo të pranojë zgjidhjen siç shprehet subjekti, për rastin konkret.

8) Ashtu sikurse arsyetuar dhe në vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë, *kallëzimi është një prej mënyrave me të cilat fillon një procedim penal*. Në dallim nga padia në një gjykim civil, e cila e kufizon Gjykatën për sa i përket kufijve të shqyrtimit të çështjes, kallëzimi nuk e pengon organin e akuzës që ta shtrijë hetimin edhe për vepra të tjera të papërmendura në të, nëse konstatohen elemente të tyre. Referuar nenit 280 të K. Pr. Penale, Prokuroria dhe Policia Gjyqësore kanë detyrimin të marrin dijeni për veprën penale, edhe kryesisht, duke i dhënë organit të Prokurorisë një rol proaktiv dhe duke mos e kufizuar vetëm në faktet dhe bazën juridike të vendosura në themel të kallëzimit.

21.8 Sa më sipër, *Komisioneri Publik* vlerëson se arsyetimi i dhënë në këtë rast nga subjekti i rivlerësimit, është i një cilësie të dobët dhe, në kushtet e mungesës së një argumentimi logjik dhe ligjor, situatë faktike, e cila vë në dyshim thelbin e vendimmarrjes së prokurorit mbi materialin kallëzues, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorin e parashikuar nga neni 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, dhe vlerëson se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, sa i përket procedimit penal nr. ***/2019, nuk janë bindëse.

22. Denoncim i përsëritur i shtetasve * dhe *** ***³⁹**

22.1 Këta shtetas kanë paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, ndaj shtetasve ***, ***, notere, ndaj Shoqërisë “**** ****”, ndaj punonjësve të ALUIZNI-it dhe atyre të ZVRPP-së, Tiranë, për veprat penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, “Mashtrim” dhe “Shpërdorim detyrë”, parashikuar nga nenet 186, 143, 248 dhe 25 të K. Penal⁴⁰.

22.2 Ky kallëzim është paraqitur më datë **.4.2019. Ndërsa, më datë **.5.2019, denoncuesit kanë paraqitur ankim pranë Komisionit me lëndë: *Kërkohet verifikueshmëria e figurës dhe anës profesionale e z. G. Habazaj*, prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Tiranë. Denoncuesit, ndër të tjera, pretendojnë *se 10 faqe kallëzim të bërë nga ato, ku referoheshin në mënyrë koncize faktet penale të ngjara dhe argumentoheshin ligjërisht veprimet kriminale të autorëve, i ka likuiduar në më pak se pesë rreshta arsyetim diletant, duke abuzuar kështu me pushtetin që i njeh ligji*.

³⁹ Me nr. *** prot., datë **.5.2019, me nr. *** prot., datë **.7.2019 dhe nr. *** prot., datë **.5.2019.

⁴⁰ Denoncuesit pretendojnë se veprat penale të kallëzuara kanë shkaktuar një dëm të madh, pasi autorët e saj, noteri së bashku me ndërtuesin ***, ***, kanë arritur nëpërmjet mashtrimit/shpërdorimit të besimit, si dhe falsifikimit të dokumenteve të tjetërsojnë tek të tretët pasuritë e tyre të paluajtshme (pasuri me sip. 169 m², garazh dhe apartament 153 m²), të cilat, sipas ekspertit, llogariten përkatësisht në vlera (126,000 euro dhe 39,000 euro). Denoncuesit pretendojnë se subjekti i rivlerësimit, në ndjekjen e procedimit penal, nuk ka marrë parasysh akt-ekspertimin e paraqitur nga ata dhe nuk ka kryer asnjë akt-ekspertim (ekzaminim nënshkrimesh), për të vërtetuar nëse qëndrojnë pretendimet e tyre sipas rezultateve të arritura nga akt-ekspertimi nr. **, datë **.9.2017, i depozituar nga kallëzuesit (kopje e të cilit gjendet bashkëlidhur këtij denoncimi).

22.3 Nga aktet, Komisionit i ka rezultuar se, referuar vendimit të datës ****5.2019**, “*Për Mosfillimin e Procedimit Penal*”, të subjektit të rivlerësimit⁴¹, vihet re se subjekti, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka thirrur dhe pyetur kallëzuesit, të cilët kanë dëshmuar se të kallëzuarit kanë falsifikuar deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë ****5.2015**, nga e cila kallëzuesit përjashtohen nga përfitimi edhe i dy pasurive të tjera (garazhet dhe papafingo), në kuadër të marrëveshjes për përfitimin e disa pasurive (40%), nga ndërtimi i një pallati 7-katësh nga shoqëria nën administrim nga ***. ***.

22.4 Këto pasuri të paluajtshme, ankuesit do t’i përfitonin si pronarë të truallit, ku do ndërtohej pallati 7-katësh. Kallëzuesit kanë pretenduar se deklarata noteriale është e falsifikuar, që do të thotë se ata nuk e kanë nënshkruar një deklaratë të tillë dhe, gjithashtu, kanë sjellë edhe akt-ekspertimin e cituar më lart, nga ku vërtetohet se nënshkrimet e tyre ishin falsifikuar. I pyetur edhe ndërtuesi *****. ***.**, ndër të tjera, ka deklaruar se: *****. dhe ***. ***** kanë nënshkruar në zyrën e noteres bashkë me të. Gjithashtu, në lidhje me akt-ekspertimin e kryer nga kallëzuesit, ai ka pretenduar se ai akt është i kundërshtueshëm, meqë është bazuar mbi dokumente fotokopje.

22.5 Subjekti i rivlerësimit, në vendimin e mosfillimit të procedimit penal nr. ******/2019**, ndër të tjera, ka arritur në përfundim se: *[...] në rastin në fjalë, kallëzimet bëhet fjalë për një akt-ekspertimi të paraqitur në Gjykatë, i cili është kryer me dokumente fotokopje dhe jo me origjinal. Kallëzimet kanë ngritur padi civile në gjykatë, e cila është rrëzuar nga Gjykata, mund të ngrihet vetëm me padi në Gjykatën Civile. Për sa më lart, fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale dhe e kemi të bëjmë me një mosmarrëveshje juridiko-civile. Në rastin del mjaft qartë se nuk kemi vepër penale [...].*

22.6 Sa më sipër, Komisioni ka konstatuar se: *[...] (1) siç shihet nga arsyetimi i këtij vendimi mosfillimi, prokurori pranon faktin e dokumentit-deklaratë noteriale e datës ****5.2018**, si dhe akt-ekspertimit të kryer nga eksperti në lidhje me ligjshmërinë e kësaj deklarate, si dokument i diskutueshëm dhe i kundërshtueshëm nga palët, por nuk urdhëron kryerjen e veprimeve hetimore për nxjerrjen e një konkluzioni bazuar në prova shkencore, siç mund të ishte urdhërimi i kryerjes së akt-ekspertimit të deklaratës objekt-kallëzimi penal, duke qenë se, sipas akt-ekspertimit të sjellë nga kallëzuesit, ka rezultuar se firmat e ankuesve/kallëzuesve janë falsifikuar. Ndërsa, paragrafi i fundit i vendimit të mosfillimit nga ana e prokurorit përmban shprehje konfuze dhe të paqarta në lidhje me konkluzionin e tij përfundimtar. (2) Duket se prokurori nuk ka kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes në drejtim të kryerjes së veprimeve procedurale, me qëllim hetimin sipas këtij procedimi penal. E parë kjo në vështrim të pikës 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, prokurori në vendimin e tij ka qenë i paqartë dhe jo i kuptueshëm në drejtim të cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik [...].*

22.7 Komisioni, lidhur me këto konstatime, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit shpjegime, si dhe informacion për statusin aktual të kësaj çështjeje.

22.8 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar: *[...] se nga praktika, kjo ankesë është shqyrtuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, i cili ka vendosur arkivimin e saj*

⁴¹ I cili gjendet bashkëlidhur dokumentacionit të denoncuesve.

[...]. Subjekti, ndër të tjera, ka parashtruar se: [...] *pretendimi i denoncuesve, se nuk janë kryer veprime hetimore për të verifikuar kallëzimin penal, nuk është i vërtetë. Pasi kallëzimi penal i është shortuar me shortin e datës **4.2019, ia ka deleguar dosjen oficerit në Prokurorinë e Rrethit Tiranë që të kryejë veprime verifikuese.*⁴² *Pasi janë kryer veprimet e mësipërme, është konkluduar me vendimin e datës **5.2019, me të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit penal për materialin kallëzues nr. **, viti 2019. Akt-ekspertimi nuk është marrë parasysh dhe nuk përmbush as kushtet e një indicieje për të kryer veprime të tjera hetimore. Ndërsa në lidhje me fjalinë “mund të ngrihet vetëm me padi në gjykatën civile” është një gabim material në tekst, i cili mund të ketë mbetur nga arsyetimi i një vendimi të mëparshëm dhe pa të teksti do të ishte: “Kallëzimet kanë ngritur padi civile në gjykatë, e cila është rrëzuar nga gjykata. Për sa më lart, fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale dhe kemi të bëjmë me një mosmarrëveshje juridiko-civile”[...].*⁴³

22.9 Në përfundim të prapësimeve të subjektit dhe akteve të vëna në dispozicion nga subjekti, Komisioni, në vendimin e tij, ka përmbledhur dhe finalizuar përfundimisht qëndrimin mbi denoncimin konkret, duke arsyetuar vetëm se: [...] *shpjegimet e paraqitura për këtë rast nga subjekti ishin të plota dhe të qarta* [...].

22.10 *Komisioneri Publik*, ndryshe nga sa ka arsyetuar Komisioni, vlerëson se shpjegimet e subjektit nuk janë të plota dhe të qarta, dhe nuk mbështeten nga aktet në dosje, për sa në vijim:

22.10.1 Referuar “*Njoftimit mbi vendimin e arkivimit të ankesave pas shqyrtimit fillestar*”, nr. ***/* prot., datë **4.2023, të ILD-së, rezulton se çështja është arkivuar, pasi pretendimet e ankuesit objekt ankese, për zbatim të gabuar të rregullave procedurale, apo materiale, për sa i përket vendimit të mosfillimit të procedimit penal dhe vendimit të Gjykatës që ka lënë në fuqi këtë vendim dhe mënyrës se si Gjykata e Shkallës së Parë ka lënë në fuqi këtë vendim, bazuar në parashikimet e nenit 291, pika 5 të K. Pr. Penale, zgjidhen mbi bazë ankimi gjyqësor, pasi ndaj vendimit, ankuesit kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën e Apelit Tiranë, të drejtë të cilën rezulton ta kenë ushtruar. Nga informacioni i marrë në rrugë elektronike nga Gjykata e Apelit Tiranë, përcjellë në ILD, në datën **1.2023, rezulton se ankimi i shtetasve ***. dhe ***. **, ndaj vendimit nr. *** akti, datë **7.2019, është regjistruar me nr. *** akti, datë **7.2019, dhe me short elektronik i ka rënë gjyqtarit ***. **, i cili nuk ka planifikuar ende datë për shqyrtimin e çështjes.

22.10.2 ILD është shprehur se, vetëm në rast cenimi të Vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, nga Gjykata e Apelit Tiranë, dhe nëse shkaqet e cenimit do jenë të natyrës që parashikohen njëkohësisht si shkelje disiplinore, kjo referuar nenit 102, të ligjit nr. 96/2016, do të përbënin shkak për të ndërmarrë nisma hetimore ndaj veprimtarisë së magjistratëve, ndaj së cilës ankohen ankuesit.

⁴² Konkretisht, nga ana e Oficerit të Policisë Gjyqësore, në datën **4.2019, u është marrë deklaram shtetasve ***. **, dhe ***. **, në datën **5.2019 i është marrë deklaram shtetasës ***. **, si dhe është mbajtur procesverbal për këqyrjen e dokumenteve të dorëzuara nga ***. **, në datën **5.2019 i është marrë deklaram shtetasit ***. **, si dhe është mbajtur procesverbal për këqyrjen e dokumenteve të dorëzuara nga shtetasi ***. **.

⁴³ Subjekti referon se: [...] *në datën **9.2019, më është ndërprerë komandimi në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë dhe është vendosur rikthimi im në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Berat. Nga shkresa nr. ***/* prot., datë **1.2024, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, rezulton se vendimmarrja ime është ende në fuqi, sepse materiali kallëzues vazhdon me status mosfillim procedimi penal* [...].

22.10.3 *Komisioneri Publik* vëren se vendimi i mosfillimit është marrë jashtë afatit 15-ditor, të përcaktuar nga neni 291 i K. Pr. Penale, dhe pasi subjekti ka kryer disa veprime hetimore, në datat **.4.2019 dhe datat ** dhe ** maj 2019, ku, ndër të tjera, janë administruar deklaratimet kontradiktorëve të palëve dhe akt-ekspertimi nr. **, datë **.9.2017, për të cilin subjekti ka disponuar se është kryer me dokumente fotokopje dhe jo origjinal.

22.10.4 Për sa më sipër, duket se, dhe në rastin konkret ka elemente për t'u vlerësuar më së paku në drejtim të aspektit të arsytimit në marrjen e vendimeve dhe veprimeve hetimore, bazuar në tregues të tillë si struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e akteve të Prokurorisë, cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik të prokurorit në përputhje me nenin 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

22.10.5 Në rastin konkret, përtej qëndrimit përfundimtar që do të sillnin rezultatet e hetimit të këtyre veprimeve hetimore, nga subjekti duket se nuk janë kryer veprime hetimore të logjikshme dhe të hollësishme, si ballafaqimi dhe verifikimi i thënieve kontradiktore të personave të përfshirë, apo përpjekje për të administruar dokumentin origjinal, për të realizuar akt-ekspertimin, për qartësimin e rrethanave të kallëzimit.

23. Denoncim i përsëritur i shtetasit * **44**

23.1 Ky shtetas ka paraqitur denoncime pranë Komisionit nga viti 2019 deri në vitin 2021, ndaj shumë subjekteve të rivlerësimit, si edhe subjektit, z. G. Habazaj. Nga dokumentacioni bashkëlidhur denoncimit gjendet vendimi për mosfillimin e procedimit penal të datës **.2.2019, të subjektit të rivlerësimit, i cili ka shqyrtuar kallëzimin penal të denoncuesit, ***, ***, për pretendimin se noteri publik, ***, ***, ka shpërdoruar detyrën funksionale, duke përpiluar një kontratë dhurimi në mashtrim/kundërshtim me ligjet në fuqi.

23.2 Ky shtetas pretendon se prona në këtë kontratë dhurimi nuk është dhuruar, por është shitur dhe ky përbën një veprim fiktiv në thelb, si dhe ai duhej njoftuar para se kontrata e dhurimit të përpilohej, kjo në respekt të së drejtës së parablerjes nga ana e tij, duke qënë se është bashkëpronar për të njëjtin objekt.

23.3 Komisioni ka arsyetuar që duket se prokurori i çështjes ka kryer një hetim të plotë e të gjithanshëm, në kuptimin e kryerjes së veprimeve hetimore verifikuese, si dhe pyetjes në cilësinë e deklaruësve dhe, në fund, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal të vitit 2019. Gjithashtu, nga dokumentacioni bashkëlidhur, duket se denoncuesi ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal dhe Gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës ankimore të tij. Sa më sipër, edhe në referim të nenit 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, Komisioni ka vlerësuar se nuk ka indicie që subjekti i rivlerësimit të mund të hetohej më tej.

23.4 *Komisioneri Publik*, nga aktet e administruara në dosje, konstaton se:

23.4.1 Kallëzimi i z. ***, ***, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Durrës, dërguar për kompetencë në Prokurorinë Tiranë, *mban datën* **.12.2018, për veprat penale të shpërdorimit të detyrës dhe falsifikimit të akteve dhe dokumenteve, kundrejt noterit ***, ***, veprën penale

⁴⁴ Me nr. ***/* prot., datë **.7.2019, me nr. ***/** prot., datë **.7.2019, me nr. ***/* prot., datë **.7.2019, me nr. *** prot., datë **.7.2021 dhe nr. *** prot., datë **.7.2021.

të shpërdorimit të detyrës kundrejt regjistruarit të ZVRPP-së, falsifikimit të dokumenteve, kundrejt shtetasit ***, ***, ***, dhe shtetasit ***, ***, ***. Kallëzuesi pretendon se ato kanë kryer një veprim juridik fiktiv, pasi në thelb, prona objekt i kontratës së dhurimit, nuk është dhuruar, por është shitur.

23.4.2 Subjekti i rivlerësimit, më datë **.2.2019, ka marrë vendim për mosfillimin e procedimit penal. Nga vendimi rezulton se subjekti, për nevoja të hetimit, ka pyetur disa nga shtetasit e përfshirë në kallëzim dhe, ndër të tjera, ka arsyetuar se, edhe sikur të vërtetohej fakti që ky dhurim ishte bërë kundrejt dëmshpërblimit, me vullnetin e lirë të palëve, kjo nuk e bën kontratën, akt noterial me përmbajtje të rremë, të falsifikuar në kuptimin e së drejtës materiale penale, por një veprim juridik, absolutisht të pavlefshëm, në kuptim të nenit 92 e 93 të K. Civil, pasi vjen në kundërshtim të hapur me dispozitat ligjore mbi kontratën e dhurimit, neni 761 K. Civil. Në rastin konkret del mjaft e qartë se nuk kemi vepër penale, ka konkluduar subjekti i rivlerësimit.

23.4.3 Nga aktet e administruara në dosje të Komisionit, duket se vendimi i mosfillimit është marrë përtej afateve të parashikuara nga neni 291/1 i K. Pr. Penale. Subjekti i rivlerësimit ka dërguar njoftimin për vendimin e mosfillimit të procedimit penal nr. ***/2019, gati 2 muaj më pas, më datë **.4.2019, dhe nuk është kryer menjëherë, sipas parashikimeve të nenit 291/2 të K. Pr. Penale.

23.4.4 Ky vendim është ankimuar nga palët në Gjykatë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, me vendimin nr. ***, datë **.6.2019, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuarit ***, ***, si të pabazuar në ligj. Ky vendim është ankimuar dhe pret të gjykohet në Gjykatën e Apelit Tiranë.

23.4.5 *Komisioneri Publik* vëren se denoncimet e përsëritura të z. ***, ***, kanë gjetur trajtim dhe gjatë procesit të rivlerësimit të tjetër subjekti rivlerësimi, për të cilin, bazuar në Rekomandimin e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, është ushtruar ankim pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit. Kallëzimet e përsëritura të shtetasit ***, ***, dhe në institucione të tjera shtetërore, kanë vënë në lëvizje Prokurorinë e Tiranës, e cila, më datë **.12.2019, bazuar në kallëzimin e Seksionit Kundër Pastrimit të Parave pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, ka regjistruar procedimin penal nr.***, për “*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*”, referuar nenit 287 të K. Penal⁴⁵. Për këtë rast, në procesin e rivlerësimit të një tjetër subjekti të rivlerësimit, të lartpërmendur, i cili edhe ai ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, vëzhguesi ndërkombëtar, me *Gjetjen* datë **.6.2023, ka referuar se Komisioni duhet të konsiderojë kryerjen e një analize të thellë të këtij rasti dhe të mangësive në kriterin e aftësive profesionale.

23.4.6 *Komisioneri Publik* vëren se në rastin konkret subjekti i rivlerësimit, z. Habazaj, duket se ka kufizuar interpretimin e të dhënave⁴⁶ të kallëzimit drejt një mosmarrëveshjeje civile, dhe nuk ka konsideruar ekzistencën e fakteve penale ose nevojën për ndjekje penale, për

⁴⁵ Referuar vërtetimit datë **.1.2020, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë.

⁴⁶ Policia Gjyqësore, ndër të tjera, ka referuar se pas lidhjes së kontratës së dhurimit, datë **.10.2018, vërehen disa depozitime (vlerë 45.000 euro) nga shtetasi ***, ***, gjatë periudhës dhjetor 2018 – janar 2019, të cilat krijojnë dyshime mbi qëllimin e tyre dhe natyrën reale të kontratës së dhurimit.

ekzistencën eventualisht të figurës së veprës penale të kallëzuar ose të tjerave që lidhen me të,⁴⁷ duke mos i dhënë zgjidhje konfliktit të palëve, që duket se vazhdon me të njëjtat rrethana dhe shumë kohë pas vendimit të mosfillimit të subjektit.

IV. Kërkimi i ankimit

24. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për kriteret e rivlerësimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë, në kuptim të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016;

25. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

26. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë;

27. Bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, Dh, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pikat 3 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016;

28. Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 736, datë 31.1.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Gentjan Habazaj.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA

⁴⁷ Referohuni më gjerësisht dhe çështjes së trajtuar në rastin e ankimit datë 31.10.2023 të IKP-së.